UDHEZUES TEKNIK

Merchant Portal

Udhezues per perdorimin e funksionaliteteve te portalit nga tregtaret

---

Qellimi:

Te ndihmoje tregtarin ne navigimin e Merchant Portal, kerkimin e transaksioneve dhe interpretimin e analizave dhe treguesve qe paraqiten ne portal.

1. Merchant Portal

Merchant Portal eshte portal i dedikuar per tregtaret qe kane te aktivizuar sherbimin. Portali ofron nje pasqyre te aktivitetit te pagesave dhe qasje ne transaksione, dokumentacion dhe njoftime.

Menuja kryesore

Permban modulet Analitika e biznesit, Transaksionet, Dokumentacion dhe Njoftimet.

Periudha

Ne faqet analitike mundeson zgjedhjen e periudhes per te cilen paraqiten te dhenat.

Filtrat

Sipas faqes mund te jene ne dispozicion filtra shtese, si kategoria e tregtarit ose emri i deges.

2. Analitika e biznesit

Moduli Analitika e biznesit mundeson percjelljen dhe analizimin e aktivitetit te transaksioneve. Te dhenat ndryshojne ne varesi te periudhes dhe filtrave te zgjedhur.

Permbledhje - Ofron pasqyren kryesore te shumes dhe vellimit te transaksioneve.

Analitika e Pagesave - Ofron analiza sipas llojit te kartes, menyres se pageses, menyres se regjistrimit dhe intervalit te shumes.

Krahasim & Parashikim - Mundeson krahasimin e performances dhe vizualizimin e trendit/parashikimit.

Analize Kohore - Mundeson analizimin e aktivitetit sipas ores, periudhes dhe, kur aplikohet, deges.

2.1 Permbledhje

Faqja Permbledhje paraqet treguesit kryesore per periudhen e zgjedhur.

01 **Shuma totale**
Vlera totale monetare e transaksioneve.

02 **Vellimi total**
Numri total i transaksioneve.

03 **Shuma dhe Vellimi total sipas dates se procesimit**
Paraqitje grafike e shumes dhe vellimit sipas periudhes.

04 **Pjesemarrja e Transaksioneve sipas Kanalit**
Shperndarja e transaksioneve sipas kanalit, p.sh. POS.

05 **Shuma totale sipas brendit te karteles**
Ndarja e vleres se transaksioneve sipas brendit te kartes Visa dhe Mastercard.

06 **Periudha e meparshme**
Kur aktivizohet, sherben per krahasimin e rezultateve me periudhen paraprake.



2.2 Analiza e pagesave

Kjo faqe ofron nje analize me te detajuar te menyres se realizimit te pagesave.

Shuma totale sipas llojit te karteles	Ndarja e shumes sipas kartelave Debit dhe Kredit.
Pagesat me kartele krahasuar me pagesat permes kuletave digjitale	Paraqet pjesemarrjen e pagesave me kartele dhe permes kuletave mobile, si Apple Pay.
Transaksionet sipas menyres se pranimit te karteles	Paraqet transaksionet me kontakt dhe pa kontakt Contactless.
Shuma mesatare sipas kategorise	Paraqet vleren mesatare sipas kanalit, pajisjes se pageses ose menyres se regjistrimit.
Transaksionet sipas intervalit te shumes	Shperndan numrin e transaksioneve sipas intervaleve monetare.
Krahasimi periodik	Treguesit PY, PY YTD, YTD, YTD %, PMTD, MTD dhe MTD % lehtesojne krahasimin me periudhat paraprake.



2.3 Krahasim & Parashikim

Kjo faqe perdoret per krahasimin e performances dhe vleresimin vizual te trendit ne vazhdim.

01 Top 5 shtetet nga vijne kartelat e perdorura per pagese

Paraqet pjesemarrjen e shitjeve sipas vendeve kryesore ku jane leshuar kartelat.

02 Krahasimi

Paraqet shumen totale dhe referencat statistikore.

03 Parashikim

Paraqet serine historike dhe vlerat e parashikuara per periudhen ne vazhdim.

04 Kategoria e Tregtarit

Mundeson filtrimin e te dhenave sipas kategorise.

05 Intervali kohor

Kontrollet nen grafik mundesojne fokusimin ne segmentin kohor te deshiruar.



2.4 Analize Kohore

Kjo faqe ndihmon tregtarin te identifikoje oret dhe periudhat me aktivitetin me te larte.

01 **Oret me me shume shitje**
Intervali kohor me aktivitetin me te larte.

02 **Transaksionet mesatare ne oren me me se shumti shtije**
Numri mesatar i transaksioneve ne intervalin e pikut.

03 **Vlera mesatare e transaksioneve gjate ores me me se shumti shitje**
Vlera mesatare e transaksioneve ne intervalin e pikut.

04 **Vlera dhe numri i transaksioneve sipas dates**
Paraqet trendin e shumes dhe vellimit sipas dates.

05 **Transaksionet mesatare per ore**
Paraqet mesataren e aktivitetit per secilen ore te dites.

06 **Emri i deges**
Mundeson filtrimin sipas deges kur ky filter eshte ne dispozicion.



3. Transaksionet

Ne seksionin Transaksionet paraqiten transaksionet ne kohe reale dhe historiku i transaksioneve te realizuara ne ditet, muajt ose vitet paraprake.

Data nga / Data deri	Percakton intervalin kohor te kerkimit.
Numri i marreveshjes baze	Mundeson zgjedhjen e marreveshjes perkatese.
Pika e shitjes	Mundeson zgjedhjen e pikes se shitjes.
Kerko	Ekzekuton kerkimin sipas kritereve te zgjedhura.
Nr. i regjistrimeve	Kontrollon numrin e rezultateve qe paraqiten.
Zgjedhja e kolonave	Mundeson pershtatjen e kolonave qe shfaqen ne tabele.
Rivendos tabelen / Pastro filtrat	Kthen tabelen ose filtrat ne gjendjen fillestare.
Eksporto ne Excel	Mundeson eksportimin e rezultateve te paraqitura ne Excel.
Kolonat e transaksionit	Mund te perfshijne emrin e tregtarit, daten, kohen, shumen, gjendjen PWCB, statusin e transaksionit, llojin dhe produktin e kartes, tarifen dhe daten e skadimit.

Verejtje:
Per te marre rezultate te sakta, kontrolloni intervalin e dates dhe filtrat aktiv para ekzekutimit te kerkimit.



4. Pakoja e sherbimit

Tregtarit i paraqitet informacioni mbi pakon aktuale te sherbimit.

Pako Expert

Pakoja Expert ofrohet si Free Trial per nje periudhe prej 6 muajsh.

Funksionalitetet

Gjate periudhes se proves, tregtari mund te perdore funksionalitetet e perfshira ne pakon e aktivizuar.

5. Dokumentacion

Seksioni Dokumentacion sherben si pike qendrore per dokumentet qe lidhen me sherbimin.

Udhezime Teknike - Hapesire ku publikohet udhezuesi teknik per perdorimin e Merchant Portal.



6. Njoftimet

Seksioni Njoftimet perdoret per paraqitjen e njoftimeve dhe informatave qe lidhen me sherbimin Merchant Portal.

Njoftimet - Kur nuk ka njoftime, portali paraqet mesazhin se nuk u gjeten te dhena.

Ndihme - Ne anen e djathte paraqitet zona e ndihmes me kontaktet per mbeshtetje, sipas konfigurimit te portalit.



Figura 1. Njoftimet dhe seksioni Ndihme (te dhenat kontaktuese jane fshehur ne kete version).

7. Rekomandime per perdorim

01 **Verifikoni gjithmone periudhen dhe filtrat aktiv para analizimit te rezultateve.**

02 **Per kerkimin e transaksioneve historike perdorni intervalin Data nga / Data deri.**

03 **Per analiza krahasuese, sigurohuni qe periudhat e krahasimit jane te pershtatshme per qellimin e analizes.**

04 **Ne rast te mospërputhjeve ne te dhena ose veshtiresive teknike, perdorni kontaktet e mbeshtetjes qe paraqiten ne portal.**